



**BASHKIA TIRANË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 31, datë 23.05.2016

**Për**  
**“MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË QENDRËS**  
**EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE DHE KLUBIT**  
**SPORTIV “TIRANA”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 54 pika ç të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” (i ndryshuar); pikës 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”; nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Vendimit e Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.03.2009, për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësisë së Bashkisë së Tiranës, për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” (i ndryshuar); vendimit e Këshillit Bashkiak nr.50, datë 20.11.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative, miratimin e rregullores dhe ndryshimin e nivelit të pagave të Klubit Sportiv “Tirana” ,vendimit nr.51, datë 11.11.2015 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave të institucioneve të varësisë”, vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve sipas lidhjes nr.5 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Klubit Sportiv “Tirana” sipas lidhjes nr.7 bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Maj të vitit 2016 dhe do të përballohen nga buxheti i këtyre institucioneve për vitin 2016.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Klubi Sportiv “Tirana”.

5. Lidhja e pagave e përcaktuar sipas lidhjes nr.7/1, në pikën nr.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.50, datë 20.11.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative, miratimin e rregullores dhe ndryshimin e nivelit të pagave të Klubit Sportiv “Tirana”, si dhe pika 2, shkronja “d” e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.7, datë 30.03.2009, për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësisë së Bashkisë së Tiranës, për përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë” (i ndryshuar) revokohen.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**

Lidhja Nr.5

Niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit & Edukimit të Fëmijëve

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
			<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
1	Drejtor i Përgjithshëm	<b>II-a</b>	1	2%	105 000
2	Drejtor	<b>II-b</b>	1	2%	80 000
3	Pergjegjes sektori	<b>III-a</b>	1	2%	55 000
4	Pergjegjes sektori	<b>III-a/1</b>	1	2%	52 000
5	Specialist I	<b>IV-a</b>	1/2/3	2%	35 000
6	Specialist II	<b>IV-b</b>	1/2/3	2%	31 000
7	Pergjegjes çerdheje	<b>IV-c</b>	1/2/3/4	2%	30 000
8	Kujdestare	<b>IV-c/1</b>	1/2/3/4/5	2%	25 000
9	Specialist i mesem,furnitor, magazinier	<b>IV-c/1</b>	4	2%	25 000
10	Kuzhinierë	<b>IV-c/2</b>	4/5	2%	23 000
11	Shofer				30 000
12	Nd/kuzhinierë ,sanitare, pastrues, punëtor magazine				28 000
13	Roje				26 000

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.5** të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, deri në **25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM E TETEVJEÇAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
<b>1</b>	<b>Diplomë e arsimit të lartë:</b>	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
<b>4</b>	<b>Diplomë e arsimit të mesëm</b>	8 000 lekë
<b>5</b>	<b>Diplomë e arsimit tetëvjeçar</b>	6 000 lekë

## Niveli i pagave për punonjësit e Klubit Sportiv “Tirana”

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore
		Kategoria	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
			1	2	3
1	Drejtor Klubi	<b>II-b</b>	1	2%	80 000
2	Trainer	<b>III-b</b>	1/2	2%	47 000
3	Pergjegjes i Zyrës së Financës	<b>IV-a</b>	1/2/3	2%	37 000
4	Specialist, Llogaritar-arkëtar	<b>IV-b</b>	1/2/3	2%	34 000
5	Masazhator	<b>IV-b</b>	1/2/3/4	2%	34 000
6	Pergjegjes terrenesh	<b>IV-c</b>	4	2%	28 000
7	Shofer, magazinier				34 000
8	Punetor terrenesh				30 000

Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr. 7 të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
<b>1</b>	<b>Diplomë e arsimit të lartë:</b>	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
<b>4</b>	<b>Diplomë e arsimit të mesëm</b>	8 000 lekë